



---

**Hapet thirrja për mobilitet stafi të UPT-së,  
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107  
në Universitetin e Milanos, (Politecnico di Milano), Itali.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit të Milanos, publikohet thirrja për mobilitet për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në Universitetin e Milanos.

**Lloji i mobilitetit përfshin:** Mobilitet për mësimdhënie dhe trajnim

**Kohëzgjatja e bursës:** 5 ditë + 2 ditë udhëtim (Semestri i dytë i vitit akademik 2025-2026)

**Numri total i stafit:** 2

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për mësimdhënie për stafin:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë dhe konfirmimi nga drejtuesi i njësisë kryesore, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës\*\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (“Staff Mobility for Teaching” or Staff Mobility for Training”) për stafin akademik në Universitetin pritës\*\*\*;

*\*Plani i mobilitetit për mësimdhënie (teaching) ose trajnim (training), si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin akademik, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga drejtuesi i njësisë bazë ku aplikanti bën pjesë, si dhe të konfirmohet nga drejtuesi i njësisë kryesore.*

*\*\*Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/ Titullar Departamenti ose program studimi/ Profesor), për kryerjen e aktivitetit mësimdhënës ose trajnim, gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisi me dokumentet e tjera të kërkuara për aplikimin tuaj.*

*\*\*\* Mobility Agreement për Teaching (mësimdhënie) or Training (trajnim) për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga Përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarte e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 3 korrik 2026, ora 12.00.**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) dhe [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)